



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË
KOMISIONI I ZHVILLIMIT TË KARRIERËS**

OPINION MBI KANDIDATIN Z. MIHALLAQ BLETA

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 53 dhe 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 05.02.2020 ka shpallur hapjen e procedurës për paraqitjen e kërkesës nga kandidaturat që vijnë nga radhët e prokurorëve, për t’u komanduar, me pëlqimin e tyre, për:

- *Këshilltar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë (6 Vende);*

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar 2 (dy) javë nga dita e shpalljes së vendimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë kanë paraqitur kërkesë 12 (dymbëdhjetë) prokurorë.

Në datë 12.02.2020 pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë është protokolluar kërkesa e prokurorit z.Mihallaq Bleta, i cili është i caktuar si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe prej një viti është i komanduar si Këshilltar pranë KLP dhe ka rishfaqur vullnetin për t’u komanduar në pozicionin e Këshilltarit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në zbatim të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 54/4 Komisioni për Zhvillimin e Karrierës përgatit një projekt-opinion për çdo kandidat dhe vlerëson nëse komandimi nuk është në përputhje me interesat e larta të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur opinionin ligjor pasi ka verifikuar, ekzistencën ose jo të ndonjë prej kriterëve ndaluese si dhe duke vlerësuar cënimin apo dëmtimin e funksionalitetit të prokurorisë ku ushtron detyrën prokurori që ka paraqitur kërkesën për komandim.

Në lidhje me kriteret ndaluese të komandimit, nga dokumentacioni i depozituar dhe dosja personale e prokurorit, rezulton se:

- Prokurori Z.Mihallaq Bleta ushtron funksionin e magjistratit që prej vitit 1982, pasi është emëruar prokuror në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë. Ai ka një eksperiencë profesionale të gjatë me rreth 38 vjet në punë si Prokuror dhe ka punuar në Prokuroritë e Librazhdit, Durrësit, Apelit Durrës, Prokurori të Përgjithshme dhe aktualisht në Lezhë. Nuk ndodhet në një pozicion me mandat të kufizuar dhe aktualisht është i komanduar prej 1 viti si Këshilltar pranë Këshillit dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Në këto kushte për këtë prokuror nuk ekziston asnjë kriter ndalues komandimi.

Në lidhje me cenimin apo dëmtimin e funksionalitetit (interesit të lartë) të prokurorisë ku kandidati ushtron funksionin, nga informacioni e mendimi i marrë nga Drejtuesi i Prokurorisë ku është i caktuar, rezulton se:

- Nga kthim-përgjigja nr.2015/1 datë 20.02.2020 e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë rezulton se nisur nga ngarkesa në punë në këtë Prokurori, komandimi i tij pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nuk dëmton interesat aktuale të Prokurorisë së Lezhës.

Në këto kushte, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës vlerëson se komandimi i z. Mihallaq Bleta në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, nuk passjell cenim të interesave të larta të Prokurorisë së Lezhës dhe nuk cënohet funksionaliteti i saj.

Mbi sa më lart, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë të Prokurorisë:

Vijimin e procedurave të komandimit për kandidatin prokuror për Z.Mihallaq Bleta.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Datë: 24.02.2020